REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË 4 –Mujorit të I-rë VITI 2026

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 48, "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor",Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 datë 30.07.2018 "Për proçedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive tëVetëqeverisjes Vendore", i paraqitim Grupit për Menaxhim dhe Strategji në bashki "Raportin e I-rë për monitorimin e zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e I-rë të vitit 2024.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Pustec për vitin 2024 është bërë në mbeshtetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.*
- *Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore",i ndryshuar.*
- *Ligjin nr.68 /2017"Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar.*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 87/2025 " Për buxhetin e vitit 2026".*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.9 datë 20.03.2018."Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.2 dt 14.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026".*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.100, datë 24.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Pustec për vitin 2026" si dhe vendimet e këshillit të marra për vitin 2026, për ndryshime gjatë zbatimit të buxhetit.*

Raporti paraqet punën e administratës të Bashkisë Pustec dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Bashkisë si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit.

Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Pustec për periudhën 4-mujore është realizuar duke zbatuar me korrektësi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e këshillit bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet gjatë 4 mujorit të I-rë të vitit 2026.

MISIONI I BASHKISË PUSTEC

Bazuar në ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", misioni i bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme ,ushtrimit efektiv të funksioneve dhe kompetencave që ka bashkia duke realizuar shërbime cilësore në përputhje me kërkesat që ka komuniteti, gjithashtu të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie.

OBJEKTIVAT E BASHKISË PUSTEC PËR VITIN 2026 janë:

1.Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomiko social, në zonën rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe rritjen e konkurrueshmërise rajonale të Bashkisë Pustec.
2.Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale për të rritur e përmirësuar akset rrugore në boshtet kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore.
3.Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shendetësisë, kulturës dhe sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare.
4.Rritja e cilësisë të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve atje ku ata banojnë.
5.Rritja e transparencës dhe mirëpërdorimi i fondeve publike në dobi të komunitetit.

Raporti i I-rë i monitorimit përmban :

Aneksi nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve";

Aneksi nr.2 "Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë";

Aneksi nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të programit";

Aneksi nr.5 "Raporti i investimeve me financim të brëndshëm";

Buxheti i Bashkisë Pustec funksionon me 10 programe si me poshtë:

1. **01110 Planifikim,menaxhim dhe administrim**
2. **03280 Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri**
3. **04240 Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitje Kullimit**
4. **04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave**
5. **04520 Rrjeti rrugor rural**
6. **09120 Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë**
7. **10430 Ndihma ekonomike dhe paaftësia**
8. **05100 Menaxhimi i mbetjeve**
9. **04910 Fondi rezervë**
10. **04940 Fondi i Kontrigjencës**

Tabela përmbledhëse e realizimit të të ardhurave sipas zërave për 4 mujorin 2025-2026 (000 leke)

Nr	Emërtimi	4 mujori I parë viti 2025			4 mujori I parë viti 2026		%
		Plan 4-mujor	Fakt	%	Plan 4-mujor	Fakt	
	Te ardhura tatimore	-	-	-			
1	Taksë Ndërtese	402	96	24%	402	102	25%
2	Taksë Trualli	23	4	17%	23	5	22%
3	Taksë Toke	434	60	14%	434	120	28%
4	Taksë tabele	3	2	67%	3	0	0%
5	Taksë Ndikimi në infrastrukturë dhe ndërtime të reja	417	546	131%	417	70	17%
6	Tatimi i thjeshtuar	0	117		0	0	
7	Regj. Automjeti në përd.	150	150	100%	150	151	100%
8	Të Ardhura nga Qeraja	216	67	31%	217	111	51%
	Shuma I	**1645**	**1042**	**63%**	**1646**	**559**	**34%**
	Të ardhura jotatimore						
1	Tarifë Pastrimi	600	194	32%	600	260	43%
2	Tarifë Ndricimi	266	61	23%	267	100	37%
3	Tarifa të ≠ ne Bashki	135	103	77%	135	84	62%
4	Tarife Mirm Varrezash	17	3	19%	17	6	35%
5	Gjoba te ≠	3	2	84%	3	1	33%
6	Tatim mbi te ardhurat personale	0	117		0	102	
	Shuma II	**1021**	**364**	**36%**	**1022**	**553**	**54%**
	Shuma I+II	**2666**	**1405**	**53%**			
	TOTALI	**2666**	**1405**		**2667**	**1112**	**42%**

Të ardhurat totale të Bashkisë Pustec për 4-mujorin e parë të vitit 2026 janë realizuar në shumën ***1,112 mijë*** lekë, kundrejt ***1,405 mijë*** lekëve të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat kanë pësuar një ulje prej ***293 mijë*** lekësh ose rreth 20.9%.

Të ardhurat tatimore janë realizuar në shumën ***559 mijë*** lekë, kundrejt ***1,042 mijë*** lekëve të realizuara në 4-mujorin e parë të vitit 2025. Krahasuar me vitin e kaluar, këto të ardhura janë ulur me ***483 mijë*** lekë ose rreth 46.4%.

Sipas zërave kryesorë të të ardhurave tatimore:

- Taksa mbi ndërtesën është rritur nga 96 mijë lekë në 102 mijë lekë, ose me 6 mijë lekë.
- Taksa mbi truallin është rritur nga 4 mijë lekë në 5 mijë lekë.
- Taksa mbi tokën bujqësore është rritur nga 60 mijë lekë në 120 mijë lekë, ose me 60 mijë lekë.
- Taksa e tabelës ka rënë nga 2 mijë lekë në 0 lekë.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ka pësuar uljen më të madhe, nga 546 mijë lekë në 70 mijë lekë, ose 476 mijë lekë më pak se një vit më parë.
- Të ardhurat nga regjistrimi i automjeteve në përdorim janë rritur lehtë nga 150 mijë lekë në 151 mijë lekë.
- Të ardhurat nga qiratë janë rritur nga 67 mijë lekë në 111 mijë lekë, ose me 44 mijë lekë.

Të ardhurat jotatimore janë realizuar në shumën ***553 mijë*** lekë, kundrejt ***364 mijë*** lekëve të realizuara në 4-mujorin e parë të vitit 2025. Krahasuar me vitin e kaluar, këto të ardhura janë rritur me ***189 mijë*** lekë ose rreth 51.9%.

Brenda këtij grupi:

- Tarifa e pastrimit është rritur nga 194 mijë lekë në 260 mijë lekë, ose me 66 mijë lekë.
- Tarifa e ndriçimit publik është rritur nga 61 mijë lekë në 100 mijë lekë, ose me 39 mijë lekë.
- Tarifat e ndryshme bashkiake kanë rënë nga 103 mijë lekë në 84 mijë lekë.
- Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave është rritur nga 3 mijë lekë në 6 mijë lekë.
- Të ardhurat nga gjobat kanë rënë nga 2 mijë lekë në 1 mijë lekë.
- Tatimi mbi të ardhurat personale ka sjellë të ardhura në shumën 102 mijë lekë,.

Në përfundim, krahasuar me 4-mujorin e parë të vitit 2025, niveli i përgjithshëm i të ardhurave ka shënuar ulje. Kjo ulje është ndikuar kryesisht nga rënia e ndjeshme e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe ndërtimet e reja. Nga ana tjetër, shumica e zërave të të ardhurave jotatimore kanë shënuar rritje, duke kompensuar pjesërisht uljen e të ardhurave tatimore dhe duke reflektuar një përmirësim të arkëtimeve nga tarifat vendore.

Problemi kryesor që hasim gjate proçesit të mbledhjes të të ardhurave janë të ardhurat nga taksat dhe tarifat për grupin familjarë. Ka vështirësi sepse një pjesë e mirë e tyre kanë emigruar jashtë Shqipërisë ose në qytete të tjera.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr. 1*"Raporti i shpenzimeve sipas programeve"* për periudhën e 4 mujorit të parë të vitit 2026.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026, Njësia e Vetëqeverisjes Vendore e Bashkisë Pustec ka realizuar shpenzime në vlerën 51,451 mijë lekë, kundrejt një plani progresiv prej 124,599 mijë lekë. Kjo tregon një nivel realizimi prej rreth 41.3% të planit, me një diferencë negative prej 73,148 mijë lekë.

Programi me realizimin më të lartë të shpenzimeve është Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, me 27,988 mijë lekë, i ndjekur nga programi MZSH me 16,156 mijë lekë. Megjithatë, edhe këto programe paraqesin mosrealizim të konsiderueshëm krahasuar me planin progresiv.

Në sektorin e arsimit, si arsimi parashkollor ashtu edhe administrimi i arsimit publik kanë shpenzuar më pak se sa ishte planifikuar, duke reflektuar ritëm më të ulët të zbatimit të aktiviteteve ose shtyrje të shpenzimeve.
Raporti tregon se niveli i realizimit të shpenzimeve në katërmujorin e parë është dukshëm më i ulët se plani i parashikuar, çka mund të lidhet me vonesa në zbatimin e projekteve, procedurat administrative ose planifikimin e shpenzimeve për periudhat e mëvonshme të vitit.

Referuar ANEKSIT 2 *"Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve"*, ep shpenzimet të grupuara sipas artikujve për të gjithë programet.

Programi 01110 ***" Planifikim, menaxhim dhe administrim"***

Objektivat:

1. Zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
2. Realizimi i shërbimeve të prokurimeve publike në kohë dhe me cilësi;
3 .Realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore;
4. Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor, mirëmenaxhimi i fondeve publike dhe menaxhimi i të ardhurave;

5. Ruajtja dhe mirëadministrimi i dokumentacionit dhe aseteve të Bashkisë;
6. Sigurimi i qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës të qytetarëve dhe puneve publike brenda territorit të Bashkisë si dhe ekzekutimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
7. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore, mbështetja e shërbimeve për blegtorinë, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit;
8. Planifikimi,zhvillimi dhe kontrolli mbi territorin.

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program ku futen shpenzimet për funksionimin e strukturave të Sektorit të Financës, Sektori i tatim-taksave, dhe strukturat mbështetëse të Kryetarit të Bashkisë.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve në programin 01110 – Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 111,499 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë ishte 60,127 mijë lekë. Gjatë periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 27,989 mijë lekë, ose rreth 46.5% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 32,138 mijë lekë.

Shpenzimet korente përbëjnë pjesën më të madhe të realizimit, me 26,591 mijë lekë, kundrejt një plani prej 41,133 mijë lekë, duke shënuar një mosrealizim prej 14,542 mijë lekë. Brenda kësaj kategorie, zërat kryesorë janë:

Pagat: 19,559 mijë lekë të realizuara kundrejt 21,608 mijë lekë të planifikuara;

Sigurimet shoqërore: 3,235 mijë lekë kundrejt 6,824 mijë lekë;

Mallra dhe shërbime të tjera: 3,797 mijë lekë kundrejt 12,701 mijë lekë.

Ndërkohë, shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm në masën 1,398 mijë lekë kundrejt një plani prej 18,994 mijë lekë, duke paraqitur diferencën më të madhe negative (17,596 mijë lekë). Kjo tregon se investimet e planifikuara gjatë katërmujorit të parë janë realizuar në nivel shumë të ulët dhe pritet të përshpejtohen në periudhat pasuese të vitit.

Në përgjithësi, programi paraqet një nivel realizimi nën planin e parashikuar, kryesisht si rezultat i mosrealizimit të investimeve kapitale dhe të një pjese të shpenzimeve operative. Kjo situatë sugjeron vonesa në zbatimin e projekteve dhe proceseve të prokurimit gjatë muajve të parë të vitit.

Programi 03280 "Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri"

Objektivat:

1. Organizimi kësaj strukture për garantimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për komunitetin, blegtorinë, ndërtesat, pyjet dhe kullotat, për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijne nga fenomene të natyrës apo nga veprimtari njerëzore.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 03280

Numri i punonjësve të planifikuar është 14 punonjës.

Buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 49,855 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 35,009 mijë lekë. Gjatë periudhës Janar–Prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 16,156 mijë lekë, ose rreth 46.1% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 18,853 mijë lekë.

Shpenzimet korente janë realizuar në vlerën 5,374 mijë lekë kundrejt një plani prej 16,073 mijë lekë, me një diferencë prej 10,699 mijë lekë. Mosrealizimi vërehet kryesisht në:

Pagat, të realizuara në masën 4,282 mijë lekë kundrejt 7,757 mijë lekë të planifikuara;

Sigurimet shoqërore, me 713 mijë lekë kundrejt 2,450 mijë lekë;

Mallra dhe shërbime, me 289 mijë lekë kundrejt 5,313 mijë lekë.

Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 10,782 mijë lekë kundrejt një plani prej 18,936 mijë lekë, duke shënuar një diferencë negative prej 8,154 mijë lekë. Kjo tregon se një pjesë e investimeve të planifikuara është realizuar, por ritmi i zbatimit mbetet nën nivelin e parashikuar.

Në përfundim, programi MZSH paraqet një nivel realizimi prej rreth 46% të planit progresiv të katërmujorit të parë. Mosrealizimi lidhet si me shpenzimet korente ashtu edhe me investimet kapitale, duke treguar nevojën për përshpejtimin e aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara gjatë pjesës së mbetur të vitit buxhetor.

04240 ***"Menaxhimi infrastrukturës së ujitje-kullimit"***

Objektivat:

1.Organizimi i punës për shrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitje kullimit me qëllim rritjen e produkteve bujqësore.

2.Organizimi i sistemit të kontrollit të përmbytjeve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04240

Ky program funksionon me 2 punonjës.

Për programin 04240 – Administrimi i Ujit të Pijshëm, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 13,529 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 9,256 mijë lekë. Gjatë

periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 780 mijë lekë, ose vetëm 8.4% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 8,476 mijë lekë.
Shpenzimet korente janë realizuar në vlerën 780 mijë lekë kundrejt një plani prej 4,019 mijë lekë, me një diferencë prej 3,239 mijë lekë. Niveli i ulët i realizimit vërehet në të gjithë zërat kryesorë:
Pagat janë realizuar në masën 421 mijë lekë kundrejt 685 mijë lekë të planifikuara;
Sigurimet shoqërore janë realizuar 70 mijë lekë kundrejt 216 mijë lekë;
Mallrat dhe shërbimet janë realizuar vetëm 289 mijë lekë kundrejt 3,118 mijë lekë të planifikuara.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ishte planifikuar realizimi i investimeve në vlerën 5,237 mijë lekë, por gjatë katërmujorit nuk është kryer asnjë shpenzim, duke rezultuar në një mosrealizim të plotë të planit për këtë kategori.
Në përfundim, programi paraqet një nivel shumë të ulët realizimi krahasuar me planifikimin, kryesisht si pasojë e mosnisjes së investimeve kapitale dhe realizimit të kufizuar të shpenzimeve operative. Kjo tregon se projektet dhe aktivitetet e planifikuara në sektorin e administrimit të ujit të pijshëm janë në faza të hershme të zbatimit ose janë shtyrë për periudhat e ardhshme të vitit buxhetor.

04260 ***"Programi pyje - kullota"***

Objektivat:

1.Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimi në mënyrë racionale i pyjeve dhe kullotave.

2.Organizimi dhe marrja e masave për vënien nën kontroll të sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje dhe parandalimin e zjarreve dhe fenomeneve të pa dëshirueshme në pyje.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04260

Ky program funksionon me 1 punonjës.

Për programin 04260 – Administrimi i Pyjeve, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 1,636 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 850 mijë lekë. Gjatë periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 545 mijë lekë, ose rreth 64.1% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 305 mijë lekë.

Të gjitha shpenzimet e realizuara i përkasin kategorisë së shpenzimeve korente, pasi programi nuk ka parashikuar dhe nuk ka realizuar investime kapitale gjatë kësaj periudhe. Brenda shpenzimeve korente:

Pagat janë realizuar në vlerën 472 mijë lekë kundrejt një plani prej 646 mijë lekë, me një diferencë prej 174 mijë lekë;

Sigurimet shoqërore janë realizuar në vlerën 73 mijë lekë kundrejt 204 mijë lekë të planifikuara, me një diferencë prej 131 mijë lekë.

Në përgjithësi, programi ka arritur një nivel realizimi më të lartë krahasuar me disa programe të tjera të bashkisë, duke realizuar mbi 64% të planit progresiv. Megjithatë, mbetet një mosrealizim prej 305 mijë lekësh, i lidhur kryesisht me shpenzimet e personelit dhe kontributet shoqërore. Programi paraqet ecuri relativisht të qëndrueshme dhe pritet që realizimi i plotë i objektivave buxhetore të përmirësohet gjatë pjesës së mbetur të vitit.

04520 Rjeti rrugor rural

Objektivat :

1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugorerurale si rrugë, ura, sheshe publike, trotuare vepra arti në të gjithë fshatrat e bashkise Pustec,me qëllim realizimin e lehtësimit të trafikut të mjeteve dhe lëvizjen e lirshme të qytetarëve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04520

Ky program funksionon me 1 punonjës.

Për programin 04520 – Administrimi i Rrugëve Rurale, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 460 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 209 mijë lekë. Gjatë periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 172 mijë lekë, ose rreth 82.3% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 37 mijë lekë.

Programi përfshin vetëm shpenzime korente, ndërsa nuk janë planifikuar apo realizuar shpenzime kapitale gjatë kësaj periudhe. Brenda shpenzimeve korente:

Pagat janë realizuar në vlerën 147 mijë lekë kundrejt një plani prej 159 mijë lekë, me një diferencë prej 12 mijë lekë;

Sigurimet shoqërore janë realizuar në vlerën 25 mijë lekë kundrejt 50 mijë lekë të planifikuara, me një diferencë prej 25 mijë lekë.

Ky program paraqet një nivel të mirë realizimi të planit progresiv, duke arritur mbi 82% të shpenzimeve të parashikuara për katërmujorin e parë. Diferenca e vogël negative tregon se aktivitetet e planifikuara janë zhvilluar pothuajse sipas parashikimeve, ndërsa ecuria financiare e programit konsiderohet e kënaqshme dhe në përputhje me objektivat buxhetore të periudhës.

Programi 09120 "*Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë*"

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore, numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit eshte 8 punonjës.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 09120

Për programin 09120 – Arsimi Parashkollor, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 22,229 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 14,235 mijë lekë. Gjatë periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 3,315 mijë lekë, ose rreth 23.3% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 10,920 mijë lekë.

Shpenzimet korente janë realizuar në vlerën 3,315 mijë lekë kundrejt një plani prej 7,046 mijë lekë, me një diferencë prej 3,731 mijë lekë. Niveli i realizimit paraqitet i ulët në të gjithë zërat kryesorë:

Pagat janë realizuar në vlerën 2,465 mijë lekë kundrejt 3,896 mijë lekë të planifikuara;
Sigurimet shoqërore janë realizuar në vlerën 412 mijë lekë kundrejt 1,230 mijë lekë;
Mallrat dhe shërbimet janë realizuar në vlerën 438 mijë lekë kundrejt 1,920 mijë lekë të planifikuara.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ishte planifikuar realizimi i investimeve në vlerën 7,189 mijë lekë, por gjatë katërmujorit të parë nuk është regjistruar asnjë shpenzim. Si rezultat, e gjithë vlera e planifikuar për investime mbetet e parealizuar.

Në përgjithësi, programi i Arsimit Parashkollor paraqet një nivel të ulët realizimi financiar gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026. Mosrealizimi lidhet kryesisht me mungesën e investimeve kapitale dhe me realizimin nën plan të shpenzimeve operative, duke treguar vonesa në zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara për këtë sektor.

***Programi* 10430 *"Ndihma ekonomike dhe paaftësia"* ,**

Janë programe që përballohen me fonde të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, planifikimi i fondeve bëhet nga ministritë përkatëse dhe realizimi është në përputhje me planin.

Programi 05100 "*Menaxhimi i mbetjeve*"

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore ,numri i punonjësve i planifikuar është 8 punonjës.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 05100

Për programin 05100 – Menaxhimi i të Ardhurave Vendore, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2026 është 9,602 mijë lekë, ndërsa plani progresiv për katërmujorin e parë është 4,914 mijë lekë. Gjatë periudhës janar–prill 2026 janë realizuar shpenzime në vlerën 2,495 mijë lekë, ose rreth 50.8% e planit progresiv, duke rezultuar me një diferencë negative prej 2,419 mijë lekë.

Të gjitha shpenzimet e realizuara i përkasin kategorisë së shpenzimeve korente, pasi programi nuk ka parashikuar investime kapitale gjatë kësaj periudhe. Brenda shpenzimeve korente:

Pagat janë realizuar në vlerën 1,777 mijë lekë kundrejt një plani prej 3,067 mijë lekë, me një diferencë prej 1,290 mijë lekë;

Sigurimet shoqërore janë realizuar në vlerën 297 mijë lekë kundrejt 969 mijë lekë të planifikuara, me një diferencë prej 672 mijë lekë;

Mallrat dhe shërbimet janë realizuar në vlerën 421 mijë lekë kundrejt 878 mijë lekë të planifikuara, me një diferencë prej 457 mijë lekë.

Programi ka realizuar rreth gjysmën e planit të parashikuar për katërmujorin e parë. Mosrealizimi është i shpërndarë në të gjithë zërat e shpenzimeve operative, veçanërisht në pagat dhe sigurimet shoqërore. Megjithatë, duke qenë se nuk janë planifikuar investime kapitale, ecuria e programit varet tërësisht nga realizimi i shpenzimeve korente. Për pjesën e mbetur të vitit kërkohet përmirësim i ritmit të zbatimit të aktiviteteve administrative dhe fiskale për të arritur objektivat e planifikuara buxhetore.

ANEKSI 4

"Raporti i realizimit të objektivave të politikës të programit"

Për plotësimin e këtij Aneksi po punojmë për të vendosur tregues sa më realë.

ANEKSI 5 paraqet realizimin e investimeve me financim të huaj dhe me financim të brendshem.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026, Bashkia Pustec ka planifikuar dhe nisur një numër projektesh investuese të financuara nga burime të brendshme dhe grante. Projektet janë të përqendruara kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, përmirësimin e banesave, pajisjen me mjete dhe makineri, si dhe përmirësimin e infrastrukturës publike.

Nga të dhënat e raportuara rezulton se gjatë periudhës janë realizuar investime në vlerën **12,180 mijë** lekë, të përqendruara kryesisht në dy projekte:

Blerje mjeti për MZSH, me realizim prej **10,782 mijë** lekë;

Një projekt parafinancimi (SMART4YOU2) me realizim prej **1,398 mijë** lekë.

Projektet e tjera të miratuara gjatë vitit 2026, si blerja e varkës, rikonstruksioni i digës së rezervuarit të Lajthizës, shtrimi i kalldrëmit, asfaltimi i zyrave, përmirësimi i banesave, blerja e projekteve teknike dhe pajisjeve të ndryshme, nuk kanë regjistruar ende shpenzime gjatë periudhës së raportimit. Kjo lidhet me faktin se shumica e tyre janë miratuar gjatë muajve mars–maj 2026 dhe ndodhen në fazat fillestare të procedurave të prokurimit dhe zbatimit.

Në përgjithësi, ecuria e investimeve gjatë katërmujorit të parë paraqitet e moderuar, me realizim të përqendruar në sektorin e mbrojtjes nga zjarri dhe në infrastrukturën rrugore. Pjesa më e madhe e projekteve pritet të gjenerojë shpenzime dhe rezultate konkrete gjatë muajve në vijim, duke kontribuar në rritjen e nivelit të realizimit të investimeve deri në fund të vitit buxhetor 2026.

Faleminderit!

Konceptoi : Pergj.Fin-Buxheti

Cvetko Nasto

KRYETARI I BASHKISË

PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUSTEC